

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nënkryetarja e Kuvendit nga Pogradeci: Siguria në shkolla, shqetësim kryesor i prindërve dhe mësuesve
ADRESA	https://www.cna.al/politike/nenkryetarja-e-kuvendit-nga-pogradeci-siguria-ne-shkolla-shqetesim-krye-i475412
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 17:00:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d82c8ac2b55b3c3c4f76d4846b8e305a2d0f60ab9fddbdd35c27771810ad0f0c
TEKSTI	963794dd37e13e786ac5c8a22921ce881b71ae392e3147e2ace6ff13ccf3ed32
PAMJA	70b8d4ad692db0bf6094d649cbf79837287ac7c46d21b1ce81d552cf4eeaffa9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1248a54b73c4a5bc7e6d93f6b02eb97390ea7d76a28bc8ff7072fb0a02e98bc9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1248a54b73c4a5bc7e6d93f6b02eb97390ea7d76a28bc8ff7072fb0a02e98bc9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Nënkryetarja e Kuvendit nga Pogradeci: Siguria në shkolla, shqetësim kryesor i prindërve dhe mësuesve



28 Shtator 2026, 18:54, Politikë CNA



Siguria e nxënësve në shkolla ka qenë në fokus të vizitës së Komisionit Parlamentar për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale në Pogradec.

Anëtarë të komisionit kanë zhvilluar takime me drejtues dhe punonjës të institucioneve të ndryshme, ndërsa një prej grupeve të punës është ndalur në gjimnazin e Pogradecit. Në qendër të diskutimeve kanë qenë masat për garantimin e sigurisë së fëmijëve, bashkëpunimi mes shkollës dhe institucioneve ligjzbatuese, por edhe problematikat e reja që lidhen me përdorimin e rrjeteve sociale dhe sigurinë në hapësirën online.

Përfaqësuesit e komisionit kanë dëgjuar nga afër shqetësimet e drejtuesve, mësuesve, oficerëve të sigurisë, punonjësve të shërbimit psiko-social, mësuesve ndihmës dhe nxënësve.





Në fjalën e saj, një prej anëtareve të këtij komisioni dhe njëherazi nënkryetaria e Kuvendit, Evis Kushi tha se në gjimnazin e Pogradecit situata paraqitet pozitive dhe puna e stafit është vlerësuar si e përkushtuar, por kjo nuk do të thotë se problematikat janë shtuar.

“Të jeni të sigurt që të gjitha vendimet që janë marrë, përfshirë këtu dhe kamerat, janë në funksion të sigurisë së nxënësve. Ky është qëllimi primar dhe është një vendimarrje që është pritur jashtëzakonisht mirë nga prindërit në radhë të parë, por padyshim edhe nga stafi i shkollës. Do të respektohen të gjitha rregullat siç i kanë me protokolle edhe vendet e tjera, siç janë standardet më të mira edhe në vendet e Bashkimit Evropian”, - theksoi Kushi.

Një tjetër nismë e diskutuar gjatë takimit ka qenë programi “After School”. Kushi tha se kjo nismë ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e prindërve, të cilët kërkojnë që fëmijët të kenë mundësi të qëndrojnë në një mjedis të sigurt edhe pas orarit të mësimin, duke e shfrytëzuar këtë kohë për aktivitetet që zhvillojnë aftësitë dhe interesat e tyre.



Mësuesit dhe prindërit kanë ngritur shqetësimin për rreziqet që mund t'u vijnë fëmijëve nga hapësira online, ndërsa sipas Kushit, kjo është një problematikë që shpesh është më e vështirë për t'u identifikuar nga shkolla, pasi konfliktet apo problematikat mund të zhvillohen jashtë ambienteve dhe orarit shkollor.

“Shqetësimi i jashtëzakonshëm i mësuesve, po edhe i prindërve, është rreziku apo rreziqet që u vijnë nxënësve, veçanërisht nga rrjetet sociale apo në përgjithësi nga rrjetet online. Shkolla ka për qëllim edhe t'i parandalojë shumë problematika, shumë incidente, po ka disa problematika që është shumë e vështirë t'i identifikosh. Një pjesë ne i shohim, ato që janë probleme edhe konflikte fizike mes nxënësve, po janë disa që shkolla e ka të pamundur, pra është pikërisht kjo pjesa që qarkullon në rrjetet sociale. Kjo është sfida: se si të bëhemi bashkë dhe t'i parandalojmë këto rreziqe që vijnë nga këto burime që janë shumë të vështira që t'i identifikosh dhe t'i parandalosh në kohë”, -tha Kushi.

Krahas sigurisë në shkolla, përfaqësuesit e komisionit kanë zhvilluar takime edhe në institucione të tjera të Pogradecit.

Shqetësimet dhe propozimet e mbledhura gjatë takimeve do të adresohen në vijim përmes punës së komisionit, ndërsa siguria e nxënësve, bashkëpunimi ndërinstitutional dhe mbrojtja e fëmijëve edhe nga rreziqet online mbeten ndër çështjet e diskutuara gjatë vizitës./CNA

CNA

05:53 | 29 shtator



BLOG

MISTERI I MASKËS EGJIPTIANE

Si kultura e lashtë përpiu grekët dhe romakët

kuriozitet

E veçanta e lajmit të raportuar është se gratë përbëjnë pjesën dërmuese të grupmoshës së mbi 100-vjeçarëve

RASTI "AGASI"

23:09 ▼

Gazetari Fundo:
Ergys Agasi ishte
zëvendëskryeminist
ër i paemëruar,
emëronte dhe
shkarkonte drejtorë

KURSI I KËMBIMIT

1 GBP = 107.24 Lek



Të sugjeruara

Skandali i SHISH-it/ Boçi: Skemë me bekimin e Ramës për kontrollin politik të Shqipërisë

Zbulohen diskutimet me Schieder/ Balla takon Raporterin e PE-së për Shqipërinë

Zhupa akuzon Ramën: Nuk i shërben dot sigurisë kombëtare, e katandisë keq shtetin

Zbardhen diskutimet e mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, ja 4 pikat kyçe

Kundër ndarjes në 100 bashki/ Manja: Kemi ngutje, nisma e PS-së të votohet para zgjedhjeve

Këshilli Bashkiak i Belshit voton kundër bashkimit me Elbasanit dhe Cërrikun

Debate në Komision/ Korreshi-socialistëve: Po tallni b*thën me Reformën Territoriale, doni vota

Skandali i SHISH-it/ Ish-presidenti: Produkt i mazhorancës, Rama të mbajë përgjegjësi politike

Rreth 2 orë me socialistët dhe kabinetin/ Zbardhet fokusi i takimit të Ramës

Një problematikë që prish takimin në tryezën e integritetit!

"Shqipëria është në rrugë të mbarë"/ Komisionerja e BE-së, Marta Kos: Mes 4 shteteve me ecuri pozitive

DETAJET/ Skandali i SHISH-it, nesër mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare

"As dorëheqje e as zgjedhje të reja"/ Muçollari: Rama pa etikë, asnjë plan kundër krimit

Ndryshime në trupën diplomatike shqiptare në Prishtinë dhe Shkup

Këlliçi i kundërpërgjigjet Ramës: Nuk ke fytyrë të dalësh para shqiptarëve, jep dorëheqjen

Shkullaku ironizon Ramën: U varfërova nga politika, s'ka bir k**ve të të gjejë lekë të shqiptarëve në xhep

Adresimi i Ramës/ Gazetari: "Lau duart" nga skandali i SHISH-it, vetë doli i ndershëm

"Bashkia Tiranë, totalisht e bllokuar"/ Alimehmeti: Telenovelë e Veliajt në kurriz të qytetarëve


Noka sulmon Ramën: I ka hyrë lepuri në bark, strumbullar i skandaleve shtetërore

Berisha udhëton në Strasburg/ Zbardhet agjenda e kryedemokratit

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.